

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,** (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Faton Ademi,** me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditëses të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim kundër të paditurit: nga fshati Komuna e Mitrovicës, baza e kontestit: Borxh, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 30.12.2013 në prezencën vetëm të përfaqësuesit të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, me datën 06.01.2014 bie këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- **OBLIGOHET,** i padituri që brenda afatit 7 ditor nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditëses shumën 178 euro ne emër te borxhit, për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike, nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.
- **OBLIGOHET,** i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditëses shumën prej 15 euro dhe ate në emër të takses per padi, ndersa ne emër shpenzimeve gjyqesore-përpilimin te ketij aktgjykimi, gjykates t'ia paguaj shumën prej 15 euro, të gjitha në afat 7 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditesja me datë: 02.09.2010 ka parashtruar në gjykatë padi për pagimin e borxhit që rrjedh nga faturat mbi pagimin e borxhit dhe kontrata për pagimin e borxhit me keste, kundër të paditurit nga Mitrovica.

Në seancën përgatitore përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadisë si dhe i kërkoj shpenzimet e procedurës.

Meqenëse I padituri më herët ka banuar në adresën e dhënë në padi ndërsa më vonë, I njëjti ka ndërruar adresën gjykata sipas propozimit të përfaqësuesit të paditëses vendosi që me të paditurin të kontaktojë përmes tabelës së shpalljeve duke afishuar ftesën por edhe vendimet për të njëjtin.

Përfaqësuesi i paditëses në seancën kryesore të datës: 30.12.2013 deklaroi se mbetet në të tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë gjykatës I propozoi ta aprovoi si të bazuar dhe ta detyroj të paditurin të paguajë në emër të borxhit shumën prej 178.36 euro si dhe shpenzimet e procedurës.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: kontrata për pagimin e borxhit me këste e lidhur në mes të paditëses dhe të paditurit dt.09.09.2009, kopja e letërnjoftimit të të paditurit, kopja e historiatit të faturimit dhe pagesave lëshuar në emër të prindit të të paditurit.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë shfrytëzues i shërbimeve telefonike, pasi kjo vërtetohet edhe nga ana e historiatit të faturimit I cili është në emër të prindit të të paditurit.

Për gjykatën nuk është konstetuese se I padituri paditëses i ka borxh shumë e cekur në padi, pasi përmes nënshkrimit të kontratës mbi pagesën e borxhit me këste I padituri pajtohet me borxhin prej 142.18 euro, mirëpo edhe pas lidhjes së kësaj kontrate I padituri ka krijuar shpenzime të reja, gjë që vërtetohet nga historiatit I faturimit dhe pagesave.

Të gjitha secat duke përfshirë edhe seancën kryesore u mbajtën në mungesë të të paditurit, për shkak se i njëjti ka ndërruar vendbanimin, andaj gjykata duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të paditëse, ftesën për seancë dhe vendimet pasuese vendosi që të paditurit t'i afishohen në tabelë të shpalljeve.

Sa i përket të drejtës material gjykata u bazua në nenin 17 të Ligjit për Marëdhëniet e Detyrimeve (Ligji I Vjetri) I zbatuar në këtë rast pasi detyrimi ka lindur në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi.

Sa i përket shpenzime procedurale gjykata u bazua në nenin 452 paragrafi I të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.Nr.189/2010 datë: 06.01.2014**

**GJYQTARI**  
**Faton Ademi**



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 7 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.